

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Drejtësia e re si sindikatë e vjetër
ADRESA	https://www.gazetatema.net/editorial/drejtesia-e-re-si-sindikate-e-vjeter-i589007
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:39:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 16:31:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cf488212bd0aec9f5d5873386f3fdd6355de30cc07e3a74f329060b280b145ad
TEKSTI	ed8884c34a2dece27621f0dd889be592cbf9497caa348bc6f3289649f407cf87
PAMJA	54d4873f2122cadff3d0e1b2290e2d4a9fdb531e355da07dc5a3d53709bd384a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7b0af6c3f39402ebd3ed2320c9b8453de5514c3716cbcbadd3337110585f1df5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7b0af6c3f39402ebd3ed2320c9b8453de5514c3716cbcbadd3337110585f1df5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

le Drejtësia e re si sindikate e vjetërPartite në Kosovë ende pa marreveshje për presidentin e ri, ndërsa afati po shkon drejt fundit"A doni të blini arme nga SHBA?" - Trump is fundit

Drejtësia e re si sindikatë e vjetër



28 Shtator 2026, 18:31Editorial Mero Baze

Kemi dy qëndrime të ndryshme të përfaqësuesve të drejtësisë së re ndaj ligjit dhe të drejtave kushtetuese. Nga njëra anë, një gjykatë miraton një rregullore që kufizon transparencën, informimin e publikut dhe mundësitë e avokatëve për të ushtruar lirisht profesionin. Nga ana tjetër, gjyqtarët reagojnë në bllok kundër një ligji të Kuvendit që përcakton nivelin e rritjes së pagave të tyre.

Në rastin e parë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka miratuar një rregullore të hartuar nga drejtuesi i saj, e cila cenon transparencën e proceseve gjyqësore. Ajo kufizon të drejtën e gazetarëve për të informuar publikun dhe vështirëson punën e avokatëve gjatë procesit, duke u mohuar përdorimin e mjeteve të punës dhe mundësinë e komunikimit normal me klientët e tyre.

Për këtë arsye, gazetarët i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar shfuqizimin e pikave të rregullores që cenojnë lirinë e informimit. Avokatët, nga ana tjetër, kanë bojkotuar seancat, pasi nuk pranojnë të kthehen në kukulla që mbushin karriget e sallës së gjyqit pa pasur mundësi të ushtrojnë të drejtat themelore të mbrojtjes.

Por drejtësia e re jo vetëm që nuk është shqetësuar nga kjo përplasje me gazetarët dhe avokatët, por duket e vendosur ta thellojë krizën, pa i dhënë asnjë mundësi dialogut dhe ndryshimit të rregullores.

Të njëjtët përfaqësues të drejtësisë, nga ana tjetër, refuzojnë të pranojnë një ligj të propozuar nga qeveria dhe të miratuar nga Kuvendi për rritjen e pagave të tyre, pasi ai nuk përmbush pritshmëritë që ata kanë vendosur vetë.

Kështu, gjyqtarët që nuk tregojnë ndjeshmëri ndaj normave kushtetuese të transparencës, lirisë së informimit dhe ushtrimit të profesionit të avokatit, kërkojnë respektimin pa kushte të çdo norme apo vendimi që lidhet me interesat e tyre financiare.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Kuvendi nuk mund t'i shpërfillë ato dhe ka detyrimin të përshtatë legjislacionin me urdhërimet e Gjykatës Kushtetuese. Por kjo nuk do të thotë se Gjykata mund t'u diktojë deputetëve se si duhet të votojnë apo të përcaktojnë vetë shumën e pagave që duhet të miratojë Kuvendi.

Gjykata Kushtetuese mund të përcaktojë kufijtë brenda të cilëve duhet të veprojnë ligjvënësi, por nuk mund të zëvendësojë Kuvendin. Deputetët kanë detyrimin të respektojnë vendimin kushtetues, por ruajnë përgjegjësinë politike dhe kushtetuese për përmbajtjen e ligjit që votojnë.

Vendimi i Gjykatës kushtetuese nuk mund të përdoret si çek i bardhë që gjyqtarët të përcaktojnë vetë pagat e tyre dhe t'ia imponojnë shumën Kuvendit. Kjo do ta kthente një pushtet që duhet të kontrollojë zbatimin e ligjit në një sindikatë që negocion me presion interesat e veta financiare.

Paradoksi është se sot kemi një pjesë të drejtësisë që kufizon transparencën dhe llogaridhënien, duke rrezikuar vijimin normal të proceseve për shkak të bojkotit të avokatëve, ndërsa, nga ana tjetër, refuzon dialogun me qeverinë dhe kundërshton ligjin e miratuar nga Kuvendi për pagat e veta.

Ky është një moment i rëndë për integritetin profesional të institucioneve të drejtësisë. Ato japin një shembull kur janë vetë subjekt i ligjit dhe një shembull tjetër kur duhet të respektojnë të drejtat kushtetuese të gazetarëve, avokatëve dhe të akuzuarve.

Kur janë përballë qeverisë dhe Kuvendit për pagat, gjyqtarët sillen si sindikalistë. Kur janë përballë gazetarëve dhe avokatëve, sillen si qeveri që nuk pranon të japë llogari.

Vetëm me ligjin nuk duan më të kenë punë.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

12 orë fitimtarë

16:10 Editorial / 97 komente

Përndjekja si "meritë" politike e Flamingove

15:55 Editorial , 37 komente

Lehtësia e papërballueshme e të mos marrit seriozisht asgjë

12:33 Editorial / 30 komente

Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalitet

14:05 Editorial / 104 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.